



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:088925

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06153711

KF.nr.548/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “I.C.” B.I me seli në Deçan dhe me numër unik identifikues 8102113976, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë e kontestit 1,641.36 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 04.09.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Kushtrim Bytyqi Avokat dhe përfaqësuesit të palës së paditur Albërie Hoxhaj Dedushi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “I.C.” B.I me seli në Deçan dhe me numër unik identifikues 8102113976.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr.01.3.2.2/6179/2020 i datës 01.04.2022, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “I.C.” B.I. me seli në Deçan dhe me numër unik identifikues 810213976, t’ia kthej shumën prej 1,641.36 € (njëmijë e gjashtëqind e dyzet e një euro e tridhjetë e gjashtë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-7082/22.05.2020, të proceduar në ZD Pejë, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e pagesës 28.05.2020 e deri në kthimin e plotë.

## A r s y e t i m

Paditësi "I.C." B.I me seli në Deçan, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 04.05.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë, të anuloj Aktvendimin e të paditurës dhe ta detyroj të paditurën që ti kthej paditësit mjetet e paguara në emër të detyrimeve të importit të paguar mbi vlerën e transaksionit me rastin e ri-vlerësimit doganor të mallit, së bashku me kamatën në shkallë prej 8 % nga data e pagesës 28.05.2020 deri në kthimin e plotë. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor publik përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbetet në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura me anë të aktvendimit të atakuar ka bërë shkelje ligjore të referuara në padi përkatësisht neni 33 të KDAK lidhur me nenin 123 të UA nr.11/2009 pasi që paditësi DUD-it kontestues i ka bashkangjitur dokumentet relevante që e vërtetojnë çmimin e paguar në emër të mallit të importuar përfshirë këtu urdhërpagesën bankare në emër të faturës së mallit. E paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit edhe në fazën e rishqyrtimit ku lënda është kthyer në rivendosje me anë të aktgjyqimit A.nr.1241/20 duke u arsyetuar me mungesën e dokumenteve të cilat nuk janë përcaktuar obligative me dispozitën ligjore të theksuar më sipër. Konsiderojmë se e paditura ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike me rastin e krahasimit të çmimit të mallit sepse DUD-at referent R-17477 dhe 18920 janë proceduar pas DUD-it kontestues, ndërsa DUD-i referent 17092 i datës 24.10.2019 është më i vjetër se sa që përcaktohet me dispozitën ligjore 71 dhe 72 të UA nr.11/2009 për krahasimin e çmimit të mallrave me qëllim të llogaritje së detyrimeve të importit. Gjykatës i dorëzoi pagesën bankare për doganën dhe urdhërpagesën e doganës.

E paditura në përgjigje në padi të datës 25.07.2024 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa nga pala paditëse nuk janë prezantuar prova të mjaftueshme dhe të harmonizuara nga ana e paditësit gjatë trajtimit të lëndës në procedurë administrative duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e të paditurës ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ka

shtuar se e paditura në procedurën e rivendosjes ka shqyrtuar edhe një herë pretendimet ankimore si dhe rekomandimet e gjykatës dhe bazuar në arsyetimin e aktvendimit të atakuar janë dhënë të gjitha sqarimet lidhur me procedurën e rivlerësimit të mallit. Sa i përket pretendimit të paditësit të cekur më lart se DUD-i referues R17477 të datës 12.06.2020 është DUD që është marrë pas importit të mallit, e paditura i sqaron gjykatës se në rastin konkret është çmim ose periudhë e përafërt me mallin kontestues dhe derisa e paditura e ka lëndën në trajtim atëherë aplikon ose merr për bazë importin që janë realizuar pas importit kontestues pasi që kjo çështje nuk është e ndaluar me asnjë dispozitë ligjore pasi që paditësi ka qenë në fazën e ankesës dhe e paditura në momentin kur gjen mallra që janë të përafërta me mallin kontestues atëherë i merre si të dhëna të disponueshme ashtu siç është vepruar në rastin kontestues. Ndërsa sa i përket DUD-it të cekur më lart nga paditësi dhe kinse e paditura ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të cekura nga paditësi i njëjti pretendim nuk ka shkelje ligjore pasi që lënda është vendosur sipas metodës së gjashtë të vlerësimit dhe ato dispozita vlejné kur çmimi përcaktohet sipas metodës së dytë dhe të tretë të vlerësimit. I propozoj gjykatës që pas administrimit të provave të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke e lënë në fuqi aktvendimin e atakuar me padi si të drejtë dhe të ligjshëm. Vlera e kontestit është e saktë siç është kërkuar nga paditësi.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 04.09.2024 ka administruar provat si në vijim: Aktvendim 01.3.2.2/6179/2020 i datës 01.04.2022, DUD R 7082 datë 22.05.2020, Faturë nr. IFAN 832 dt. 15.04.2020, Swift konfirmimi i datës 20.05.2020, Kontratë e datës 05.12.2017, Packing list 15.04.2020, Urdhërpagesë bankare dhe transaksion për doganën në vlerë prej 10,056.22 euro, Aktgjykim A.nr.1241/20, Aktvendim 01.3.2.2/6179 i datës 27.06.2020, Proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD R 7082, Ankesë e paditësit në doganë e datës 29.05.2020, Faturë IFANW14901 e datës 05.09.2019, DUD referent R 18920, Fletë dërgesë e datës 20.04.2020, Urdhër kthimi i mjeteve i datës 26.06.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve në seancë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për

Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata konstaton se e paditura, ndonëse ka nxjerr vendimin e kontestuar në ri-procedurë nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës të paraqitura në Aktgjykimin nr.1241/20 të datës 12.01.2022. Në vend të kësaj ajo ka marrë një aktvendim që bie ndesh me udhëzimet dhe vërejtjet e dhëna nga Gjykata, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së. Gjykata gjithashtu konstaton se, sikurse në aktvendimin e parë me nr. 01.3.2.2/ 6179 të datës 27.06.2020, edhe në aktvendimin tani kontestues nr. 01.3.2.2/206/2020 të datës 10.09.2021, e paditura ka ofruar arsyetim të njëjtë lidhur me bazën ligjore mbi të cilën e ka mbështetur vendimin e kontestuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues i marr në riprocedurë sipas aktgjykimit A.nr.1241/20, gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit. Dogana e Kosovës - Sektori për Rishqyrtim të Vendimeve në ri procedurë ka analizuar edhe një herë çështjen kontestuese dhe ka ardhur në përfundim se Sektori i Pranimit Qendror nuk ka vepruar drejtë kur mallin lëndor e ka rivlerësuar në lartësinë e bazës për llogaritje të taksave doganore, kjo pasi ë Sektori i Pranimit Qendror për reference kishte marrë deklaratën unike doganore R18920/21.06.2020 ku nuk është kontestuese ngjashmëria e mallit, por Sektori për Rishqyrtime vlerëson se kur kemi të bëjmë me rivlerësime duhet të gjenden mallra të cilat kanë ngjashmëri më te madhe me mallin lëndor kontestues si për nga përshkrimi dhe të dhënat në rubrikën 31 te DUD-it, andaj Sektori për Rishqyrtime të Vendimeve me qëllim të vendosjes se çështjes në mënyrë sa me meritore ka bërë analiza në sistemin COGNOS dhe ASYCUDA dhe ka gjetur se në periudhën e përafërt kohore të zhdoganimit përkatësisht në muajin Qershor 2020 si R17477/12.06.2020 është zhdoganuar mall i ngjashëm me mallin lëndor me çmimin prej 1.49 €/kg, gjithashtu në vitin 2019 vetë subjektit i ishte rivlerësuar malli lëndor me çmimin prej 1.44 € kg sipas R17092/04.10.2019 pra janë deklarata unike doganore më të përafërta se sa DUD-i ku është referuar Sektori i Pranimit Qendror, prandaj Sektori për Rishqyrtime të Vendimeve duke bërë krahasimin e këtyre mallrave të ngjashme të cilat përputhen në specifika të mallit, ka arritur në përfundim se subjektit mundë ti pranohet vlere prej 1.50€/kg, por jo në çmimin ashtu siç e ka deklaruar subjekti në procedurë. Tutje lidhur me vërejtjet e gjykatës se e paditura duhet të deklarohet lidhur me pagesën ndërkombëtare dëshmuar përmes Swift konfirmimit të datës 20.05.2020, ka argumentuar se gjatë administrimit të dokumentacionit të prezantuar kemi vërejtur se askund në

kontratën e prezantuar nga subjekti në procedure nuk ceken çmimet e që në rastin konkret kontrata është akt juridik që lidhet në mes të palëve dhe duhet të përmbajë edhe çmimet e mallit. Tutje ka argumentuar se bazuar ndërsa lidhur me vërejtjet e gjykatës lidhur me arsyetimin e të paditurës lidhur me harmonizimin e dokumentacionit, e paditura në arsyetim të vendimit kontestues ka argumentuar se bazuar në zhdoganimet e mallit të ngjashëm vërehet se ky lloj i mallit me karakteristika të ngjashme në periudhë të përafërt kohore është zhdoganuar me çmim më të lart se sa vlera e deklaruar nga subjekti në procedurë si dhe kontrata e prezantuar nga subjekti në procedurë nuk përmban çmimet e mallit andaj nuk mund të pranohet vlera e deklaruar konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se *“a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë

konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi pas analizimit të faturës IFAN 832 të datës 15.04.2020 dhe Swift konfirmimin e NLB Bankës të datës 20.05.2020 përmes të cilës është bërë pagesa e faturës nr.IFAN832 në vlerë prej 14,614.00 USD, e sipas të cilës konstaton se në faturën IFAN 832 të datës 15.04.2020 evidentohet shuma prej 14,614.00 \$ (dollarë amerikan), e cila shumë është e njëjtë me Swift konfirmimin në shumë prej 14,614.00 \$ (dollarë amerikan).

Pas analizimit të faturës IFAN 832 të datës 15.04.2020, gjykata konstaton se çmimi në faturë është çmimi real i cili është paguar dhe se kjo vërtetohet edhe me konfirmim e pagesës të faturës e që rezulton që çmimi të jetë paguar sipas vlerës së deklaruar.

Po ashtu Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së 6 të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e gjashtë e vlerësimit, duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it, R-7082/22.05.2022, të proceduar në ZD Pejë, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 1,641.36 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka vërtetuar se pagesa nga fatura nr. IFAN832 e datës 15.04.2020 e deklaruar me DUD-it, R-7082/22.05.2022 është realizuar përmes Swift konfirmimit të datës 20.05.2020 në vlerë prej 14,614.00 \$, në të cilën pagesë është shënuar numri i faturës IFAN832. Prandaj, arsyetimin e të paditurës si në vendimin kontestues se askund në kontratën e prezantuar nga subjekti në procedure nuk ceken çmimet e që në rastin konkret kontrata është akt juridik që lidhet në mes të palëve dhe duhet të përmbajë edhe çmimet e mallit, për gjykatën është i pabazuar meqenëse asnjë dispozitë ligjore nuk e përcakton detyrimin e tillë për palën.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumente e prezantuara të paditurës lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuar dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata konform nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 1,641.63€, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it kontestues të proceduar në ZD Pejë, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e pagesës 28.05.2020 e deri në kthimin e plotë.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas kërkesës së paditësit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet “*Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apellesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme*” dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se “*Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që*

*nga momenti i shkaktimit të dëmit” dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se “Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës sipas dëshmisë së pagesës së detyrimeve doganore të datës 25.08.2020, është marrë data e kësaj pagese e deri në kthimin e plotë.*

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.548/22, datë 04.09.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.